




Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



### Formulari i Ankesës

E rezervuar për PZAP-in

NUMRI I REGJISTRIT TË VENDIMEVE \_\_\_\_\_

Shih faqen vijuese për udhëzime të hollësishme lidhur me mënyrën e parashtrimit të ankesave

#### A. IDENTIFIKIMI I PARASHTRUESIT TË ANKESËS

Nëse parashtruesi i ankesës është organizatë apo subjekt politik:

1. Emri i organizatës/subjektit politik që parashtron ankesën \_\_\_\_\_
2. Emri i personit të caktuar për kontaktim \_\_\_\_\_
3. Posti i personit të caktuar për kontaktim \_\_\_\_\_
4. Adresa \_\_\_\_\_
5. Komuna \_\_\_\_\_
6. Nr. i telefonit \_\_\_\_\_ 7. Nr. i faksit \_\_\_\_\_
8. E-maili \_\_\_\_\_

Nëse parashtruesi i ankesës është individ:

1. Emri KUS HRIM CUKAJ
2. Përkatësia politike nëse i përket ndonjë subjekti politik
3. Adresa R.R. DURAGJINI #40
4. Komuna PEJË
5. Nr. i telefonit 045-734-734 6. Nr. i faksit \_\_\_\_\_
7. E-maili kushrim.cukaj@kls-gen.net
8. Data e lindjes 

Data	Muaji	Viti
73	12	1971

 9. Numri i regjistrimit civil/ si votues 1009842876

#### B. KRYESI I SUPOZUAR I SHKELJËS

Nëse kryesi i supozuar është individ/organizatë apo subjekt politik:

1. Emri i individit/organizatës apo subjektit politik \_\_\_\_\_
2. Posti zyrtar i personit, nëse ka të tillë \_\_\_\_\_
3. Adresa \_\_\_\_\_
4. Komuna \_\_\_\_\_
5. Nr. i telefonit \_\_\_\_\_ 6. Nr. i faksit \_\_\_\_\_
7. E-maili \_\_\_\_\_

### C. SHKELJA/SHKAKU I ANKESËS

Përshkruani ankesën tuaj në hollësi, duke përfshirë vendim, datën dhe kohën e shkeljes së pothuaj. Luteni ta përshkruani natyrën e shkeljes dhe nëse është e mundur të specifikoni dispozitat ligjore që mendoni se janë shkelur. Nëse është e nevojshme, mund të bashkëngjiti fletë shtesë. Bashkangjitur dërgoni kopjet e çfarëdo dëshmie që mbështet ankesën tuaj.

ANKIMIM I VENDIMIT TË PZAP-SË  
A nr. 1099/2013, ENDERUAR PZAP  
ANKOHEM PZAP PRANË DUSH  
LIDHUR ME VENDIMIN MBI ANKESËN  
QË KAM PARASHTRU ME HRET.  
DU KAM SJELL DËSHIMI DOKUMENTET  
2 JRTARE KU SHIFET NË FPAR  
TË MËNSHKRUAR NGA AVËTARËT E  
KËSHILLIT TË VENDITIMIT QË NUK  
ËSHËN BËRËJE BAKTJA E VOTAVE PËR  
KANIDAT POK VETËM PËR PARTI  
SIKURSE ËSHËN PUBLIKUAR NË  
KQZ TË CILËN JAU KAM BASHKANGJITË

### D. DËSHMITARI (ËT) E MUNDSHËM (BASHKANGJITUR EDHE DEKLARATAT)

Lutemi të shënoni emrin dhe organizatën ose subjektin politik të cilit i përket dëshmitari(ët) i/e mundshëm. Nëse është e mundur, duhet të shënohen të dhënat për kontaktim (adresa, numri i telefonit, numri i faksit dhe e-maili). Nëse është e nevojshme, mund të bashkëngjiti fletë shtesë.

UNË JAM VOTUES AHC DËSHMOJ  
DË VOTA IME NUK ËSHËN NUMRU  
DREJTES QKA SHIHET NË DOKUMENTË  
PËRKANTËSË

Sipas njohurive që une posedoj, informacioni i mësipërm është i saktë.

(Nëse parashtruesi i ankesës është organizatë ose subjekta politik, atëherë atë duhet ta nënshkruaj përfaqësuesi i autorizuar)

KUSHTRIM CUKAJ

Emri dhe Mbiemri

Nënshkrimi

Data

12/12/2013

### PARASHTRIMI I ANKESAVE PRANË PZAP-it

Çdo person, i cili ka interes ligjor ose që pohon se i janë shkelur të drejtat që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, mund të parashtrorë ankesën pranë Panelit të Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP). Kjo në mes tjerash, përfshin, por nuk kufizohet në:

- Aplikantët;
- Votuesit;
- Partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e certifikuar;
- Anëtarët e KQZ-së dhe të Sekretariatit të tij;

Për të parashtruar ankesë, duhet të plotësohet formulari i PZAP-it për ankesa. Formulari i ankesave është në dispozicion në gjuhën Shqipe dhe Serbe, në zyrën e PZAP-it në Prishtinë, si dhe në të gjitha Qendrat e Votimeve gjatë ditës së zgjedhjeve.

Që të shqyrtohet kjo ankesë, ajo duhet të përmbajë informatat vijuese:

- Pohimin mbi shkeljen e një rregullore të zgjedhjeve, ose të ndonjë urdhërese administrative që ka të bëjë me procesin zgjedhor;
- Përshkrimin sa më të hollësishëm të pohimit mbi shkeljen/incidentin; dhe
- Nënshkrimin në formular që tregon se të dhënat janë të sakta sipas njohurisë së parashtruesit të ankesës.

Duhet të plotësohen të gjitha rubrikat e zbatueshme të formularit. Nëse ndonjë rubrikë nuk mund të zbatohet, atëherë duhet të shënohet si "e pazbatueshme".

Është me rëndësi të jepen të dhënat për kontaktim të parashtruesit të ankesës, në mënyrë që PZAP-i mund të kontaktojë me parashtruesin e ankesës në rast hetimi dhe pasi të jetë marrë vendimi përfundimtar përkitazi me ankesën.

Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet brenda tri ditësh pas pohimit mbi shkeljen ose pasi të jetë i informuar parashtruesi i ankesës për atë shkelje.

Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë.


Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në Qendren e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Parashtrimi i ankesës bëhet drejtpërdrejt në zyrën qendrore të PZAP-it në Prishtinë. Po ashtu ankesat mund të lihen në kutitë postare të PZAP-it që gjenden në Prishtinë dhe në Zyrën e Sekretariatit të PZAP-it. Vendimet përfundimtare të PZAP-it bëhen publike; megjithatë dosjet e lëndëve mbeten plotësisht konfidenciale dhe të gjitha hetimet janë konfidenciale.

Ky Informacion duhet të dorëzohet në adresën: Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP)

“Rruga “Luan Haradinaj” Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës - Kati I

Prishtinë 10 000 Republika e Kosovës



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1099/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Kushtrim Cukaj nga Komuna e Pejës, paraqitur kundër Komisionereve të qendrave të vendotimeve, për shkak të parregullsive në manipulim e votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Kushtrim Cukaj nga komuna e Pejës.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Kushtrim Cukaj nga komuna e Pejës i cili thekson se në qendrat e votimit 1703c shkollën fillore “Lidhja e Prizrenit” në Pejë, si dhe në vendvotimin 1703/01R votat e familjës dhe e imja personale për kandidatën e PDK-së Afërdita Lajçi të cilës nuk i figurojnë të numëruara dhe nuk ka asnjë votë. Në Këtë rast mendoj se është bërë shkelje dhe manipulim i votës së lirë, dhe kërkoj që të numërohet vota ime.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi se nga dëshmit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Kushtrim Cukaj nga komuna e Pejës. PZAP-i, i vlerëson si të pabazura dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1099/2013 më datën 06.12.2013



***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 ( njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.



## 17 Pejë/Peć

1703C/01R

#	EMRI I PARTISË / NAZIV PARTIJE	VOTAT/ GLASOVA
1	40 NCPK - NARODNA CRNOGORSKA PARTIJA KOSOVA	0
2	48 PREBK - PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	0
3	49 SDA-SDSG	10
4	50 VAKAT - KOALICIJA VAKAT	1
5	55 Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK)	2
6	61 LËVIZJA VETËVENDOSJE!	38
7	62 AAK-LDD ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS LDD	92
8	67 NOVA SNAGA	0
9	70 Partia e Drejtësisë - PD	29
10	78 LDK - LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	118
11	87 PDKI - Partia Demokristiane Për Integrim	2
12	89 AKR - ALEANCA KOSOVA E RE	18

13	92 BSDAK - BOŠNJACKA STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE KOSOVA	0
14	94 BALLI KOMBËTAR I KOSOVËS - BKK	6
15	99 PDK - PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	40
16	111 ADK - ALTERNATIVA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	3
17	113 IRDK - Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës	0
18	126 G.I.SRPSKA	0
19	130 Samostalna Liberalna Stranka - SLS	0
20	131 LËVIZJA SOCIALE E KOSOVËS	1
21	136 Crnogorska Liberalna Stranka - CLS	0
22	137 INICIJATIVA-SABAHUDIN CIRIKOVIC	3

